# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434836**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sejko, takim me BERZH - Fokus te kreditimi, bizneset e vogla dhe integrimi në BE |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/ekonomia/sejko-takim-me-berzh-fokus-te-kreditimi-bizneset-e-vogla-dhe-integrimi--i585162` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 11:42:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 12:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9918d5df50ca7f3dc588e8c0bd40d0c54d53cb15e5aad33f4e343d4945dc2e37` |
| TEKSTI | `6d86adc0b9981500c2b844f77dd71d6b84bb68edc3e23f3074ed7ad6f6681627` |
| PAMJA | `c16c9fffbf1138a056b125668c0efa8105fc1ac93d9f12422ba8b4f7b0064d37` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c6e9ce28d19098416fefe3f75816422e89a9a475399de28dde2b2097154c2e72` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c6e9ce28d19098416fefe3f75816422e89a9a475399de28dde2b2097154c2e72`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Sejko, takim me BERZH - Fokus te kreditimi, bizneset e vogla dhe integrimi në BE

10 Shtator 2026, 14:25Ekonomia TEMA

Sejko, takim me BERZH - Fokus te kreditimi, bizneset e vogla dhe integrimi

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, zhvilloi një takim me Francis Malige, Drejtor Menaxhues për Institucionet Financiare në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Në qendër të diskutimeve ishte bashkëpunimi mes Bankës së Shqipërisë dhe BERZH-it, zhvillimet në sektorin bankar, rritja e kreditimit të ekonomisë dhe procesi i përafrimit të kuadrit rregullator shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian.

Një tjetër temë e rëndësishme ishte ecuria e kreditimit të ekonomisë, veçanërisht financimi i sektorit privat. Sejko vlerësoi se sistemi bankar shqiptar vijon të karakterizohet nga kapitalizimi, likuiditeti dhe qëndrueshmëria, duke krijuar premisa për vijimin e mbështetjes së ekonomisë përmes kreditimit.

Ai nënvizoi se zgjerimi i kreditimit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe të shëndetshme, duke ruajtur cilësinë e portofolit të kredisë dhe standardet e administrimit të rrezikut.

Në takim u diskutua edhe programi i Bankës së Shqipërisë për financimin e bizneseve mikro dhe të vogla. Programi synon të lehtësojë aksesin e tyre në financim dhe të mbështesë investimet dhe zgjerimin e aktivitetit ekonomik.

Përfaqësuesit e BERZH-it e vlerësuan pozitivisht nismën dhe shprehën gatishmërinë për të mbështetur Bankën e Shqipërisë, si dhe për të shqyrtuar mundësi konkrete bashkëpunimi për zbatimin e saj.

Një pjesë e veçantë e diskutimeve iu kushtua procesit të ekuivalencës së kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës bankar shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Guvernatori Sejko theksoi progresin e bërë ndër vite në përafrimin e kuadrit rregullator dhe praktikave mbikëqyrëse me standardet evropiane. Sipas tij, ky proces është i rëndësishëm për forcimin e sektorit bankar dhe integrimin financiar të Shqipërisë në tregun evropian.

Palët diskutuan gjithashtu mbështetjen për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe forcimin e mekanizmave të sigurisë financiare, ndërsa u vlerësua asistenca e BERZH-it për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Çmimet e gazit në Evropë rriten në nivelet më të larta që nga viti 2023

20:10 Ekonomia

Durrësi zgjeron kanalizimet - Karakaçi: 85 milionë euro grant europian për impiantin dhe rrjetet e ujërave të ndotura

17:00 Ekonomia / 1 koment

Inteligjenca artificiale futet në prokurimet publike, Ibrahimaj jep afatin: Brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm! Teknologjia, rruga për të luftuar korrupsionin

16:00 Ekonomia / 3 komente

Ligj për "Made in Albania"? - Musabelliu: Drafti gati, mekanizma për nxitjen e eksporteve

14:40 Ekonomia / 2 komente

Guvernatori Sejko takohet me përfaqësuesit e Bankës Botërore: Shqipëria ecuri pozitive në rritjen dhe stabilitetin ekonomi

13:30 Ekonomia / 1 koment

Ish-qiramarrësit kredi pa interes - Ministrja Ibrahimaj: Aplikimi kryhet në e-Albania

11:25 Ekonomia / 1 koment

Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe europianët: 29% për ushqime, gati trefishi i BE-së

08:35 Ekonomia / 2 komente

Shqipëria pjesë e Kodit Global- Nga të dhënat te financimi, forcohet mbështetja për gratë sipërmarrëse

15:20 Ekonomia / 1 koment

Fatura e aksidenteve - AMF: Kompanitë e sigurimit paguan mesatarisht 175 mijë lekë për dëmet motorike

16:10 Ekonomia / 2 komente

Shqiptarët paguan 70 mln euro për të rivlerësuar pronat

15:20 Ekonomia / 3 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Republika popullore e protestës**

15:20 Editorial / 113 komente

**“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...**

11:53 Politika / 101 komente

**Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...**

14:50 Kronika / 19 komente

**U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...**

15:13 Politika / 73 komente

**Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...**

13:40 Bota / 40 komente

## Blog Tema

**Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet**

12:38 Blog / 5 komente

**Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?**

10:25 Blog / 19 komente

**Dinjitet nuk ka vetëm deputeti…**

09:42 Blog / 21 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.